



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-88036/24 dt.08.07.2024, të kërkuarëve/pronarëve, Fitim Sylja nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, përkatësisht 3 (shtëpi), 2 (dy) shtëpi të Tipit “A”, dhe 1 (një) shtëpi të Tipit “C”, të ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, në rr. “Andrea Durrsaku” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 15.10.2024, lëshon këtë:

C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LEJOHET kërkuarëve / pronarit Fitim Sylja nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, sipas kërkesës 05-391/02-88036/24 dt.08.07.2024, përdorimi i 3 (tri), ndërtesave/shtëpi individuale të banimit, Tipi “A” (dy shtëpi) me etazhitet P+1 dhe Tipi “C” (një shtëpi) me etazhitet P+1, dhe të ndërtuara sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-169107/22 dt.14.12.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelat kadastrale nr. 1297-1, 1297-2, dhe 1295-17, ZK. Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Andrea Durrsaku” ku janë dalje hyrjet e këtij kompleksi të shtëpive me numrat: 24, 26 dhe 28, në Prishtinë, dhe e njejtat do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuarësi / pronari, Fitim Sylja nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, me kërkesën 05-391/02-88036/24 dt.08.07.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për 4 (katër), ndërtesa/shtëpi individuale të banimit, Tipi “A” (dy shtëpi) me etazhitet P+1 dhe Tipi “C” (një shtëpi) me etazhitet P+1, të ndërtuara në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1297-1, 1297-2, dhe 1295-17, ZK. Çagllavicë, ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05

Faqe 1 prej 2

Nr.351/02-169107/22 dt.14.12.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-235096/23 dt. 01.02.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenar Veseli; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Skender Loshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Gresë Qorri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arton Hetemi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike dhe instalimet e makineris konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-88036/24 DT. 15.10.2024

Zyrtarja,

Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

